

Raporti i Komisionit për shqyrtimin e ankesave në lidhje me Konkursin për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësisive akademike të UP - së me Nr. Prot.: 1/909, dt 1.8.2023

Komisioni për shqyrtimin e ankesave, i emëruar me vendim të Këshillit të Fakultetit të Filologjisë, me Nr.Prot.: 01/3499, dt 8.9.2023, është mbledhur më 9.10.2023 për ta shqyrtuar ankesën e kandidatës Arta Sejdiu (nr. prot. 03/4427, dt. 6.10.2023). Komisioni për ankesa gjatë shqyrtimit të ankesës në fjalë ka marrë parasysh dosjen me të cilat kandidatja ka aplikuar për angazhim në cilësinë e bashkëpunëtores të jashtëm për ushtrime në pozitën nr. III.8 dhe raportin e Komisionit vlerësues për pozitën në fjalë.

Parashtruesja e ankesës në ankesën e saj pretendon se plotëson kushtet e konkursit më mirë sesa kandidatja e përzgjedhur.

Komisioni i ankesave ka rishikuar dokumentacionin e aplikimit të kandidatës Arta Sejdiu. Në dokumentacionin e përmendur parashtruesja e ankesës, znj. Sejdiu, sipas pikës V të Konkursit me Nr. Prot.: 1/909, dt 1.8.2023, ka dorëzuar diplomën e studimeve baçelor me Nr. 4871 si dhe certifikatën e notave të studimeve baçelor me Nr. Prot.: 04/118, dt 10/01/2020, nga të cilat vërtetohet se e kandidatja Sejdiu në studimet themelore e ka notën mesatare: 7.98.

Rregullorja e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. prot. 01/95, dt.24.06.2021, në neni 7, pika 3.2 e paragrafit 3 parasheh që kushtet që kandidatët duhet të kenë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit.

Prandaj komisioni për shqyrtimin e ankesave konsideron se ankesa e kandidatës Arta Sejdiu është e pabazuar.


Prishtinë, më 9.10.2023

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË
PRISHTINË


Pranuar me: 09/10/2023			
Nj. org.	Numer	Shtojca	Vlera
03	4512	3	-

Komisioni:

1. Prof.ass.dr. Remzie Shahini Hoxhaj – kryetare



2. Prof.dr. Nuran Muhaxheri – anëtare



3. Prof. ass. dr. Shpëtim Elezi – anëtar

